VENDIM
Nr. 852, datë 30.9.2013

PËR REVOKIMIN E EMËRIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE DHE PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 310, DATË 19.4.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 "Për statistikat zyrtare", të ndryshuar, dhe të neneve 121 dhe 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Revokimin e emërimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave, organ drejtues i INSTAT-it, si më poshtë vijon:

- Znj. Diana Shtylla, drejtore e Departamentit të Statistikave të Bankës së Shqipërisë;
- Z. Endrit Lami, drejtor i Drejtorisë së Makroekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme Makroekonomike dhe Fiskale, në Ministrinë e Financave;
- Znj. Liri Hajdari, përgjegjëse e sektorit të statistikës, në Drejtorinë e e-Edukimit dhe Statistikës, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës;
- Znj. Eriola Furxhi, përgjegjëse e sektorit të koordinimit dhe publikimit, në Drejtorinë e Monitorimit dhe Analizës, në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Znj. Juna Miluka, përfaqësuese e botës akademike;
- Z. Sami Neza, përfaqësues i shoqërisë civile;
- Znj. Viola Puci, përfaqësuese e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë.

2. Vendimi nr. 310, datë 19.4.2013 i Këshillit të Ministrave "Për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Statistikave", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama